



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 11 prill 2018
Nr. ref.: RK 1214/18

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI81/17

Parashtrues

Rapsina Muslija

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të
Kosovës, AA. nr. 4436/2016, të 22 dhjetorit 2016**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Rapsina Muslija nga Prizreni (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, AA. nr. 4436/2016, të 22 dhjetorit 2016, me të cilin është refuzuar si e pabazuar ankesa e saj kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P. nr. 650/16, dhe të cilat janë në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 78/2017, të 20 prillit 2017.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtrueses, janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës, në nenin 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 12 korrik 2017, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 13 korrik 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu- Krasniqi.
7. Më 9 tetor 2017, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje e kësaj kërkesë iu dërgua Gjykatës Supreme të Kosovës.
8. Më 22 shkurt 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesja e kërkesës paraqiti padinë në Gjykatën Themelore në Prizren për anulimin e kontratës hipotekare ndërmjet parashtrueses së kërkesës (paditëses) dhe të paditurve A. M. dhe ProCredit Bankës, me seli në Prishtinë.
10. Parashtruesja e kërkesës së bashku me padinë paraqiti edhe propozimin për caktimin e masës së përkohshme me të cilën do të duhej të ndalohet qarkullimi juridik dhe ngarkimi i ngastrës kadastrale e cila është objekt i kontestit, si dhe ndërprerjen e të gjitha veprimeve përmbaruese në procedurën e përmbarimit [I. nr. 10/2016], deri në përfundimin e procedurës kontestimore.

11. Më 12 qershor 2016, Gjykata Themelore në Prizren, përmes Aktvendimit [P. nr. 650/16] aprovoi propozimin për caktimin e masës së përkohshme. Në arsyetimin e këtij aktvendimi, Gjykata Themelore, *inter alia*, thekson: *“Gjykata, pas analizës dhe vlerësimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, erdhi në përfundim se propozimi i palës paditëse për caktimin e masës së sigurimit për momentin është i bazuar për faktin se ekziston rreziku se pa caktimin e masës do të vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesave të palëve”*.
12. Ndaj këtij aktvendimi, e paditura ProCredit Banka paraqiti kundërshtim, ndërsa gjykata e shkallës së parë sipas nenit 306, paragrafi 2, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK) caktoi seancën.
13. Më 2 gusht 2016, Gjykata Themelore në Prizren, përmes Aktvendimit [P. nr. 650/16] aprovoi kundërshtimin dhe anuloi masën e përkohshme të sigurimit të caktuar me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren [P. nr. 650/16], të 12 qershorit 2016, dhe urdhëroi që të vazhdohet procedura kontestimore. Në arsyetimin e këtij aktvendimi, Gjykata Themelore, *inter alia*, pretendon: *“Pas analizimit të shkresave të lëndës, kundërshtimit të paditurit të dytë, deklarimin e të paditurit të parë dhe palës paditëse, gjykata erdhi në përfundim se kanë ndryshuar rrethanat në të cilat është caktuar masa e përkohshme e sigurimit nga ana e kësaj gjykate. Kjo për faktin se gjatë shqyrtimit gjyqësor nga ana e të paditurit të dytë Bankës ProCredit janë dorëzuar provat me të cilat është dëshmuar se pala paditëse ka nënshkruar kontratën për kredinë pranë të paditurit të dytë, përkatësisht se e njëjta i kishte dhënë pëlqimin të paditurit të parë (bashkëshortit të saj) për marrjen e kredisë nga ana e të paditurit të dytë”*.
14. Parashtruesja e kërkesës kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit.
15. Më 22 dhjetor 2016, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [AA. nr. 4436/2016] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin [P. nr. 650/16] e Gjykatës Themelore në Prizren, të 2 gushtit 2016.
16. Më 31 janar 2017, parashtruesja e kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës, kundër Aktvendimit [AA. nr. 4436/2016] të Gjykatës së Apelit.
17. Më 20 prill 2017, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev. nr. 78/2017] hodhi poshtë si të palejueshëm revizionin e parashtrueses së kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesja e kërkesës pretendon se vendimet e gjykatave të rregullta me të cilat është anuluar masa e përkohshme e sigurimit i kanë shkelur të drejtat e saj të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

19. Parashtruesja e kërkesës, në thelb, konteston mënyrën në të cilën gjykatat e rregullta e kishin vërtetuar gjendjen faktike me rastin e marrjes së vendimit për anulimin e masës së përkohshme të sigurimit.
20. Parashtruesja pretendon se ajo nuk e kishte nënshkruar kontratën për hipotekë, se gjykatat nuk e morën parasysh këtë fakt kur kanë vendosur për anulimin e masës së përkohshme të sigurimit, dhe se në këtë mënyrë, sipas pretendimeve të saj, ia kanë shkelur të drejtën e bashkëpronësisë prej 50% në pronën nga bashkësia bashkëshortore.
21. Nga sa u tha më lart, parashtruesja konsideron se me vendimet e gjykatave të rregullta janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
22. Parashtruesja e kërkesës më tej kërkon nga Gjykata vlerësimin e kushtetutshmërisë së akteve të lartpërmendura [Aktvendimi i Gjykatës Themelore-Prizren, P. nr. 650/16, të 2 gushtit 2016, Aktvendimi i Gjykatës së Apelit-Prishtinë, AA. nr. 4436/2016, të 22 dhjetorit 2016, dhe Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, CML. nr. 78/2017, të 20 prillit 2017], *“Dhe të njëjtat të jenë në pajtim me dispozitat Kushtetuese”*.

Pranueshmëria e kërkesës

23. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara më tej me Ligj dhe të parashikuara me Rregullore të punës.
24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:
 1. *Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
 - [...]
 7. *Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*
25. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës e parashtrroi kërkesën në cilësinë e palës së autorizuar, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike.
26. Megjithatë, Gjykata i referohet edhe nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili përcakton:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.
27. Gjykata merr parasysh edhe rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

“[...]

(c) kërkesa parashtrohet brenda 4 (katër) muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi [...]”.

28. Në fillim, Gjykata i referohet datës së dorëzimit të vendimit përfundimtar të parashtrueses dhe datës kur kërkesa është dorëzuar për të vlerësuar nëse ajo e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të paraparë prej 4 (katër) muajsh.
29. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin më 22 dhjetor 2016, i cili i është dorëzuar parashtrueses më 10 janar 2017. Parashtruesja dorëzoi kërkesën e saj në Gjykatë më 12 korrik 2017.
30. Gjykata rikujton se afati 4 (katër) muaj fillon të ecë nga data e dorëzimit të këtij vendimi përfundimtar (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, *Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, parashtrës nr. 46477/99, Aktgjykimi i 14 marsit 2002).
31. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se kërkesa për revizion të parashtrueses e dorëzuar në Gjykatën Supreme, nuk është në pajtim me nenin 228 (1) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, i cili përcakton: *“Palët mund të paraqesin revizionin vetëm kundër aktvendimeve të formës së prerë me të cilat përfundon procedura e gjykatës së shkallës së dytë.”*
32. Në fakt, Gjykata vëren se Gjykata Supreme në arsyetimin e saj, ndër të tjera, theksoi se *“Në rastin konkret bëhet fjalë për masën e sigurimit të kërkesëpadisë, ndërsa kontesti nuk është përfunduar në mënyrë meritore, prandaj për këto arsye dhe në pajtim me dispozitën ligjore të lartcekur revizioni është i palejueshëm...”*.
33. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, të 22 dhjetorit 2016, përfundoi procedura në gjykatat e rregullta lidhur me propozimin e parashtrueses për vendosjen e masës së përkohshme.
34. Gjykata konsideron se në këto rrethana, kërkesa për revizion kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, AA. nr. 4436/2016, të 22 dhjetorit 2016, nuk ishte mjet efektiv ligjor dhe nuk ka mundur të ketë pritshmëri legjitime për sukses të këtij mjeti. Në fakt, me ligj shprehimisht përcaktohet se një mjet juridik i tillë nuk është i lejuar për t’u dorëzuar. Shih, rastin e Gjykatës Kushtetuese KI135/16, parashtruesi i kërkesës: *Tomislav Janković dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, të 27 tetorit 2017, paragrafi 25.
35. Gjykata përsërit *“se mund të merren parasysht vetëm ato mjete të cilat janë efektive, pasi që parashtruesit nuk mund ta zgjasin afatin kohor strikt të cilin e imponon Konventa, duke u përpjekur të ushtrojnë kërkesa të papërshtatshme apo të dërguara gabimisht në organet apo institucionet të cilat nuk kanë mundësi për të ofruar mjetin juridik efektiv për ankesën e dhënë”* (shih, *mutatis mutandis*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në

tekstin e mëtejme: GJEDNJ), rastin *Fernie kundër Mbretërisë së Bashkuar*, parashtresa nr. 14881/04, Vendim për pranueshmëri, i 5 janarit 2006).

36. Gjykata rikujton se pasi që Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, AA. nr. 4436/2016, i 22 dhjetorit 2016, i është dorëzuar parashtrueses asgjë nuk e ka ndalur atë për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, ajo e ka shfrytëzuar mjetin juridik i cili nuk është i lejuar me ligj.
37. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se periudha 4 (katër) mujore fillon të ecë nga data e dorëzimit të vendimit përfundimtar i cili është rezultat i shterjes së mjeteve juridike të cilat janë adekuate dhe efektive për të siguruar kompensimin në lidhje me çështjen e cila është objekt i ankesës (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Norkin kundër Rusisë*, parashtresa nr. 20156/11, Vendim për pranueshmëri, i 5 shkurtit 2013; dhe shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës Kushtetuese KI201/13, parashtruesi i kërkesës: *Sofa Gjonbalaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 prillit 2014, paragrafi 32).
38. Gjykata rikujton se “*në qoftë se asnjë mjet juridik nuk është i disponueshëm apo nëse vlerësohet se ato janë joefektive*”, afati kohor 4 (katër) mujor i paraparë me nenin 49 të Ligjit në parim ecë nga data e dorëzimit të aktit i cili është objekt i ankesës (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Bayram dhe Yildirim kundër Turqisë*, parashtresa nr. 38587/97, Vendimi i 29 janarit 2002).
39. Gjykata, më tej, rikujton se qëllimi i afatit ligjor 4 (katër) mujor, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës është që të promovojë sigurinë ligjore, duke siguruar se rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të shqyrtohen brenda një afati të arsyeshëm dhe se vendimet e mëparshme nuk janë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar (shih, rastin e GJEDNJ-së, *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, parashtresa nr. 23274/04, Vendim për pranueshmëri, i 25 gushtit 2005).
40. Në bazë të asaj që u tha më lart, Gjykata konsideron se vendimi përfundimtar në kërkesën e parashtrueses është Aktvendimi AA. nr. 4436/2016, i Gjykatës së Apelit, i 22 dhjetorit 2016. Prandaj, afati kohor fillon të ecë prej 10 janarit 2017, që është data e dorëzimit të vendimit të lartpërmendur tek parashtruesja. Parashtruesja e parashtroi kërkesën e saj më 12 korrik 2017. Periudha 4 (katër) mujore për parashtrimin e kërkesës ka skaduar më 10 maj 2017.
41. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa nuk është parashtruar brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.
42. Si përfundim, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtrueses është e papranueshme sepse është parashtruar jashtë afatit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113. 1 dhe 7 të Kushtetutës, në nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 22 shkurt 2018, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetarija e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

